

Marrëveshje e Praktikës Profesionale

Për

Kandidat me Kontratë Pune me Kohë të Plotë

Ndërmjet të nënshkruarëve,

Zotit/Zonjës _____, Auditues Ligjor, i quajtur në këtë marrëveshje
“Drejtues i praktikës profesionale”;

dhe

Zotit/Zonjës _____, i quajtur në këtë Marrëveshje “Kandidat për
Auditues Ligjor”, me qëndrim në adresën _____
të cilët kanë rënë dakort si më poshtë:

Neni 1

Palët deklarojnë se janë njohur me rregullat për kryerjen e praktikës profesionale dhe angazhohen të respektojnë ato si dhe udhëzimet që u janë dhënë ose do t’u jepen nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Neni 2

Drejtuesi i praktikës profesionale angazhon në praktikën profesionale Zotin/Zonjën _____, për një periudhë minimale 3 vjet. Konform pikës 6 të Rregullores së Edukimit dhe Kualifikimit Profesional, kandidati do t’i kushtojë të paktën 800 orë në vit punëve që do t’i besojë drejtuesi i praktikës profesionale. Palët deklarojnë se koha e punës pranë Drejtuesit të praktikës profesionale është:

nga dita _____ deri në ditën _____,

nga ora _____ deri në orën _____.

Neni 3

Pagesa e akorduar e kandidatit në formë honorari arrin në shumën _____ Lekëⁱ. Shpenzimet profesionale të kandidatit për llogari dhe me pëlqim të drejtuesit të praktikës profesionale janë në ngarkim të këtij të fundit.

Neni 4

Drejtuesi i praktikës profesionale angazhohet të ndihmojë në formimin profesional të kandidatit duke i besuar atij veprime të supozuara dhe faktike që t’i sigurojë atij në mënyrë progresive njohuri teorike dhe praktike sa më të plota mbi profesionin për të cilin aspiro.

Neni 5

Kandidati angazhohet t'i përkushtohet praktikës profesionale me vullnet të mirë dhe kompetencë, të kryejë me ndërgjegje misionet që do t'i ngarkohen nga drejtuesi dhe të mbajë një ditar të praktikës profesionale në të cilin do të përshkruajë veprimet e kryera apo ato në të cilat ka marrë pjesë. Ky ditar do të hartohet dhe ruhet sipas kujdesit të parashikuar nga sekreti profesional.

Neni 6

Kandidati angazhohet të mos dëmtojë interesat e drejtuesit të praktikës profesionale, si gjatë praktikës profesionale dhe pas tij. Ai do të ruajë konfidencialitetin për faktet mbi të cilat ka marrë njohuri gjatë praktikës profesionale të tij dhe nuk do të pranojë misione të cfarëdoshme të klientëve të drejtuesit në tre vitet pas përfundimit të praktikës profesionale ose ndërprerjes së kontratës, vetëm në rast miratimi formal ose të shkruar të drejtuesit të praktikës profesionale.

Neni 7

Gjysma e parë e vitit të parë të praktikës profesionale do të konsiderohet si periudhë prove. Gjatë kësaj periudhe në cdo moment secila palë mund të ndërpresë kontratën nëpërmjet një lajmërimi një muaj para. Njoftimi i arsyetuar do t'i jepet edhe Komitetit të Edukimit profesional pranë IEKA-s.

Neni 8

Në përfundim të periudhës së provës, praktika profesionale mund t'i jepet fund me pëlqimin e palëve ose për një arsye të caktuar të vlerësuar nga Komiteti i Edukimit Profesional, pas dëgjimit të palëve.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e pranimit në praktikën profesionale të zotit/zonjës _____, nga Komiteti i Edukimit Profesional pranë IEKA-s.

Bërë në tre kopje, me datë _____, nga të cilat një kopje mbahet nga Kandidati një kopje nga Drejtuesi i praktikës profesionale dhe një kopje nga IEKA.

Kandidati
(Nënshkrimi)

Drejtuesi i Praktikes Profesionale
(Vula dhe Nënshkrimi)

ⁱ Referuar vendimit të KD Nr 63 datë 27.12.2013